



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr. 5/6 Prot

Vlorë, më 15.07. 2021.

VENDIM

Nr.3, datë 08.07.2021

PËR

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE ME OBJEKT, "NDËRTIMI I RRUGËS PORTI I JAHTËVE-BYPASS ORIKUM-DUKAT (URA E SHËN ELIZËS)", ME VENDNDODHJE: BASHKIA VLORË**



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë.

**VENDOSI:**

1.Miratimin e kërkesës së shoqërisë koncesionare "Rruga Orikum-Llogara" sh.p.k, për autorizim për përdorimin e burimit ujqorë për veprimtari ndërtimore në brigje me objekt "Ndërtimi i rrugës Porti i Jahtëve-Bypass Orikum-Dukat (Ura e Shën Elizës)" me vendndodhje Bashkia Vlorë.

2. Vendodhja e strukturave (koordinatat KRGJSH).

- 1.X-455618.8; Y-4466455.9; Z-5.62; Ura Nr.1 Orikum;
- 2.X- 458931.6; Y- 4459433.7; Z-141.18; Ura Nr.1 Dukat;
- 3.X- 460173.5; Y- 4458269.3; Z-185.8; Ura Nr.2 Dukat;
- 4.X- 460858.0; Y- 4457934.8; Z-224.5; Ura Nr.3 Dukat;
- 5.X- 461619.2; Y- 4457180.3, Z-265.32; Ura Nr.4 Dukat;
- 6.X-456120.9; Y- 4465464.2; Z-13.02; Prita Lumore Nr.1 Orikum;
- 7.X-456377.8; Y- 4464303.0; Z-25.65; Prita Lumore Nr.2 Orikum;
- 8.X-456700.8; Y- 4462382.4; Z-59.46; Prita Lumore Nr.3 Orikum;

9 X-458582.3; Y-4460078.4; Z-121.17; Prita Lumore Nr.4 Orikum.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**



**FLAMUR MAMAJ**

*Flamur Mamaj*